



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Rasti A. nr. 445/2018

RAPORT ME REKOMANDIME

I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje me

regjistrimin me numër të ri të lëndëve, të cilat kthehen në rigjykim nga gjykata më e lartë

Drejtuar:

Z. Nehat Idrizi, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë, më 29 nëntor 2018

PËRMBAJTJA

QËLLIMET E RAPORTIT	3
BAZA LIGJORE	3
ANALIZA JURIDIKE.....	4
ZBATIMI NË RASTIN KONKRET.....	6
KONSTATIMI DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT	7
A. Konstatimi i Avokatit të Popullit.....	7
B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit	7

QËLLIMET E RAPORTIT

1. Qëllimi i këtij raporti është njoftimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut, në rastet e regjistrimit me numër të ri të lëndëve të cilat kthehen në rigjykim.
2. Po ashtu, qëllimi i këtij raporti është për t'u dërguar institucioneve kompetente rekomandime specifike dhe konkrete që nëpërmjet legjislacionit, të specifikojë afate për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore.

BAZA LIGJORE

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton se: “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”.
4. Neni 135, paragrafi 3, përcakton se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.
5. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “Avokati i Popullit ka kompetencë për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.” (neni 16, par. 1);
 - “Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. . . ”. (neni 16, par 8).
 - “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënpar. 2);
 - “t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
6. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

ANALIZA JURIDIKE

7. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNJ).
8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, përcakton se: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, garantohen me Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”*
9. KEDNJ, neni 6, paragrafi 1 përcakton se: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet (...) në një afat të arsyeshëm, nga një gjykatë (...) që do të vendosë (...) për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, (...).”*
10. Avokatit i Popullit vëren se në gjykatat të cilat gjykojnë çështjet në shkallë të parë, ekziston një praktikë në bazë të së cilës, lëndët të cilat kthehen në rigjykim dhe rivendosje regjistrohen me numër të ri. Një praktikë e tillë bartet edhe në gjykatat e instancave më të larta, duke mos marrë parasysh faktin se rasti gjyqësor mund të jetë shumë më i vjetër nga data e paraqitjes së tij në gjykatë, si në rastet e përcjelljes së rastit në gjykatën e shkallës së dytë, ashtu edhe në situatat kur rasti kthehet në rigjykim.
11. Avokati i Popullit vëren se:
 - (1) Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, në nenin 7, paragrafi 2, përcakton se: *“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”;*
 - (2) Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, në nenin 7, paragrafi 5, përcakton se: *“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve”;*
 - (3) Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, në nenin 10, par. 1 të po këtij ligji përcakton se: *“Gjykata ka për detyrë të përpiket që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”.*
12. Avokati i Popullit, po ashtu, vëren se Ligji për Procedurën Kontestimore në kapitullin XXVI [Procedurat e posaçme kontestimore], ka parashikuar situata kur gjykatat duhet të zgjidhin rastet në mënyrë të ngutshme.
13. Nga shqyrtimi i ligjeve vërehet se ligjvënësi nuk i ka parashikuar afatet brenda të cilave një çështje e iniciuar në gjykatën kompetente duhet të zgjidhet.
14. Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, garantohen me Kushtetutë,

zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Një ndër tetë instrumentet ndërkombëtare është KEDNJ.

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31, si dhe KEDNJ, neni 6, përcaktojnë të Drejtën për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, ku, një ndër komponentat e kësaj të drejte, është e drejta për një proces gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm kohor.
16. Ngjashëm sikur legjislacioni vendor, as KEDNJ nuk përcakton se cili është afati i arsyeshëm kohor, brenda te cilit duhet të përfundojë një rast gjyqësor. Mirëpo, ekziston praktika e etabluar e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), përmes të cilës janë interpretuar çështjet rreth garancive kohore, brenda të cilave duhet të zgjidhet një çështje që është në shqyrtim gjyqësor.
17. Sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.
18. Lidhur me këtë: *“Duke kërkuar respektimin e “afatit të arsyeshëm”, KEDNJ nënvizon rëndësinë se drejtësia nuk duhet dhënë me vonesa që cenojnë efikasitetin dhe besueshmërinë (H. kundër Francës, § 58 ; Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë, § 61). Neni 6 § 1 i detyron Shtetet kontraktuese të organizojnë gjykatat në mënyrë që t’i përgjigjen kërkesave të kësaj dispozite”.*
19. GJEDNJ, tutje ka vendosur një standard, sipas të cilit *“Kur flasim për pikënisjen e afatit, bëhet fjalë në parim për datën e paraqitjes së çështjes në gjykatën kompetente (Poiss kundër Austrisë, § 50 ; Bock kundër Gjermanisë § 35), me përjashtim kur paraqitja para një autoriteti administrativ përbën një kusht paraprak për paraqitjen në gjykatë, rast në të cilin afati mund të përfshijë edhe kohëzgjatjen e procedurës administrative paraprake të detyrueshme (König kundër Gjermanisë § 98 ; X kundër Francës, § 31; Kress kundër Francës [GC], § 90)”.*
20. Sa i përket termit *“afat”*, ky në parim mbulon të gjithë procesin, duke përfshirë këtu organet e administrative (König kundër Gjermanisë, § 98). Ai shtrihet deri në vendimin që e ka zgjidhur përfundimisht çështjen (Poiss kundër Austrisë, § 50). Kështu, kërkesa për respektimin e afatit të arsyeshëm shtrihet në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore që synon zgjidhjen e çështjes, pa përjashtuar fazat që pasojnë vendimet meritore (Robins kundër Mbretërisë së Bashkuar §28).
21. Sipas GJEDNJ, *“Vetëm zvarritjet që i ngarkohen Shtetit mund të çojnë në përfundimin se ka pasur një moszbatim të afatit të arsyeshëm” (Buchholz kundër Gjermanisë, § 49; Papageorgiou kundër Greqisë, § 40 ; Humend kundër Polonisë [GC], § 66). Shteti është përgjegjës për tërësinë e shërbimeve: për autoritetet gjyqësore, por edhe për çdo institucion publik” (Martins Moreira kundër Portugalisë, § 60).*
22. GJEDNJ, gjithashtu, thekson se: *“Është detyrë e shteteve kontraktuese të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në mënyrë që gjykatat të mund t’i garantojnë gjithkujt të drejtën*

për të marrë një vendim përfundimtar për çështjet që lidhen me të drejtat dhe detyrimet të natyrës civile në një afat të arsyeshëm (ibidem; Scordino kundër Italisë, [GC], § 183)."

23. Në fakt, përderisa Shtetet anëtare duhet të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në mënyrë të tillë që të garantojë të drejtën për një vendim gjyqësor në një afat të arsyeshëm, mbingarkesa e punës nuk mund të merret parasysh (*Vocaturò kundër Italisë, § 17; Cappello kundër Italisë, § 17*). Kështu, fakti që situatat e mbingarkesës janë bërë të zakonshme, nuk mund të justifikojë tej zgjatjen e një procesi (*Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, § 40*)."

ZBATIMI NË RASTIN KONKRET

28. Avokati i Popullit nga ankesat që ka pranuar ndaj gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit, lidhur me zvarritjet procedurale, në raportet e publikuara ka konstatuar se në këto raste është shkelur neni 6 dhe 13 i Konventës që ka të bëjë me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kohor.
29. Gjatë trajtimit të këtyre rasteve është vërejtur që numrat e regjistrimit të këtyre lëndëve ndryshojnë nga një gjykatë e shkallës së parë në Gjykatën e Apelit. Po ashtu, vërehet që lëndët kur kthehen në rigjykim, ato regjistrohen me numër të ri dhe figurojnë si lëndë të reja.
30. Ky raport fokusohet veçanërisht në efektin që e ka regjistrimi më numër të ri rendor të rasteve të kthyer në rigjykim, në zvarritjen procedurale, rrjedhimisht shkeljen e të drejtës për një proces gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm.
31. Së pari, duhet theksuar se, regjistrimi me numër të ri rendor nuk parashihet me ligjet në fuqi. Është e arsyeshme që ligjdhënësi nuk ka parashikuar diçka të tillë, sepse në të kundërtën do të krijohesh ex-lege një bazë për zhvendosje të lëndës nga renditja fillestare, në rend me padi të iniciuara shumë më vonë.
32. Së dyti, regjistrimi më numër të ri rendor nuk mund të krahasohet me asnjërin nga kriteret objektive të përlllogaritjes së vonesave procedura, sepse vet regjistrimi me numër të ri, krijon përshtypjen se lënda është iniciuar shumë më vonë, ndërsa vlerësimi i shkresave të lëndës e shfaqë pastaj datën reale të inicimit të rastit.
33. Avokati i Popullit vëren se legjislacioni i zbatueshëm në Republikën e Kosovës nuk parasheh afate rreth kohëzgjatjes së gjykimit në secilën instancë, por as për maksimumin e tërësisë së gjykimit, mirëpo KEDNJ, e cila drejtpërdrejtë aplikohet në Kosovë dhe ka prioritet mbi ligjet nacionale, e po ashtu edhe praktika e GJEDNJ, parashohin mundësinë që gjykimi të zhvillohet brenda një afati të arsyeshëm kohorë.
34. Sipas praktikës së GJEDNJ, afati fillon të rrjedhë në momentin e inicimit të padisë në gjykatën kompetente, ndërsa për raste administrative edhe më herët. Është fakt notor se procedurat gjyqësore, që në shkallë të parë fillojnë të trajtohen disa vite pasi padia është dorëzuar në gjykatë.

35. Është e vërtetë që gjyqësori është i ngarkuar me lëndë, por sipas GJEDNJ-së ky nuk përbën justifikim. Është detyrë e shtetit që të organizojë një sistem gjyqësor i cili i trajton me efikasitet lëndët. Gjithashtu, inicimi i procedurave me qëllim reformimi të sistemit gjyqësor, reformim i cili do të përshpejtonte trajtimin e lëndëve, po ashtu nuk përbën justifikim.
36. Për më tepër, regjistrimi me numër të ri rendor të lëndëve është rezultat i mungesës së një akti i cili do të rregullonte mënyrën e regjistrimit të lëndëve në gjykata.
37. Avokati i Popullit konsideron se një veprim i tillë, cenon liritë dhe të drejtat themelore të individit. Një veprim i tillë, i shkaktuar nga faktor subjektiv paraqet një pengesë ndaj qytetarëve për arritjen e një vendimi përfundimtar, brenda një afati objektiv, në procedurat gjyqësore.
38. Përfundimisht, Avokati i Popullit konstaton se regjistrimi i lëndëve sipas vitit të paraqitjes së padisë dhe mos ndryshimi i tyre kur lënda kalon nga njëra shkallë në tjetrën, është në interes të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

KONSTATIMI DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

A. Konstatimi i Avokatit të Popullit

39. Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se: regjistrimi me numër të ri rendor i rasteve të kthyera në rigjykim dhe rishqyrtim, përbën shkelje të së drejtës për një vendim gjyqësor brenda një afati objektiv, si komponentë e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
40. Ky veprim, përpos që nuk paraqet afatin real (vitin) kur është iniciuar padia në gjykatën kompetente, shkakton vonesa të reja, duke bërë që rasti të mos trajtohet brenda një afati të arsyeshëm.

B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit

24. Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 1 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon :

Këshillin Gjyqësor të Kosovës

- (1) Ta adresojë këtë çështje në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që Kuvendi, nëpërmjet legjislacionit, të specifikojë afate për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore, duke specifikuar afatin maksimal që tolerohet nga inicimi i padisë e deri të vendimi i shkallës së parë, por edhe afatet e shqyrtimit në instancat tjera.

(2) Deri në nxjerrjen e një akti nga Kuvendi i Kosovës, KGJK të nxjerrë një akt të brendshëm i cili do të rregullonte afatet për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore, duke e specifikuar afatin maksimal që tolerohet nga inicimi i padisë e deri te vendimi i shkallës së parë, por edhe afatet e shqyrtimit në instancat e tjera.

(3) Në aktin e brendshëm gjithashtu të përcaktohet se rastet që kthehen në rigjykim duhet të trajtohen me prioritet në krahasim me paditë e reja

25. Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit